

VEPRIMTARIA E SHKOLLËS SË MESME TË ULËT “ LIRIA “ NË STROC, SIPAS
DOKUMENTACIONIT TË SHKOLLËS DHE ARKIVIT KOMUNAL

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARKIVISTIKËS

nga

AGRON MUSTAFA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

Mars, 2024

REZYME

VEPRIMTARIA E SHKOLLËS SË MESME TË ULTË “LIRIA” NË STROC, SPAS DOKUMENTACIONIT TË SHKOLLËS DHE ARKIVIT KOMUNAL

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriore të Kosovës. Në jug të Vushtrrisë, në një largësi prej 18-20 km, gjendet fshati Stroc, i cili ka një trashëgimi kulturore dhe materiale shumë të pasur që nga periudhat ilire, romake e bizantine. Në këtë lokalitet gjendej Gjyteti i Strocit, themelet e të cilit ruhen edhe sot. Stroci gjatë historisë pësoi dëme të mëdha materiale dhe njerëzore. Në vitin 1917, forcat austro-hungareze dënuan me vdekje të riun e këtij fshati, Fejzulla Hasani, kinse për vrasjen e popit serb në Prelluzhë, kurse në vitin 1920, forcat serbe vranë për një ditë 26 burra. Në vitin 1941, sipas një sërë të dhënash historiografike, çetnikë të Drazha Mihajloviqit, të ndihmuar edhe nga popullata serbe e këtij fshati, sulmuan fshatrat e Artakollit: Strocin, Bivolakun, Zhilivodën, Beçukun, Mihaliqin etj., por këta u kundërpërgjigjën dhe zmbropsin. Strocasi u dalluan edhe në Pazarin e Ri e gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku shumica u rreshtuan në anën e tribunit popullor Shaban Polluzha. Një kontribut të veçantë Strocasi dhanë në luftën e fundit në radhët e UÇK-së.

Në kontekst të arsimit, duhet theksuar se shqiptarët krahas luftës për liri, bënë jo pak përpjekje për hapjen e shkollës shqipe. Në kohën e Perandorisë Osmane të gjithë popujt e nënshtruar kishin të drejt të mësonin në gjuhët e tyre, ndërsa shqiptarët e kishin të ndaluar një gjë të tillë. Në këtë kontekst, edhe në komunën e Vushtrrisë si në jo pak treva të tjera, zhvillimi i arsimit shqip, nis relativisht vonë, pra tek në vitin 1915, në rrethanat kur kjo pjesë ishte nën pushtimin austro-hungarez. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, Kosova u pushtua nga italianët, gjermanët e bullgarët. Pushteti i instaluar gjerman në Vushtri, nuk pengoj hapjen e shkollave shqipe, për çfarë kemi të evidentuar hapjen e një sërë shkollash në qytetin e Vushtrrisë dhe në fshatrat e saj. Vlen të vihet në pah fakti se me ripushtimin e Kosovës nga Jugosllavia komuniste shkollat shqipe nuk u mbyllën. Përkundrazi, pushteti komunist, për ta përfituar popullin shqiptar, hapi në fillim në të gjitha fshatrat shkolla shqipe, por më vonë do të vij deri të mbyllja e shkollave në shumë fshatra shqiptare. Nxënësit e këtyre shkollave shqipe nëpër fshatrat shqiptare, pushteti komunist i grumbulloi në shkolla, në fshatrat që ishin të banuara me serb.

Në Stroc për herë të parë shkolla shqipe u hap në vitin 1947. Procesi mësimor filloi në shtëpi-shkollë. Për mungesë lokali, mësimi lëvizti nga Stroci në Beçuk, në vitin 1954 në Gllavotin, e në vitin 1973 përsëri në Stroc. Krahas zhvillimit të procesit edukativo- mësimor në shkollë u krijuan dokumente. Arkivi i shkollës në Stroc u themelua paralel me fillimin e mësimin. Kur jemi tek themelimi i arkivave, duhet vënë në pah se ato janë institucione të cilat evidentojnë, pranojnë, ruajnë, konservojnë, rregullojnë, përpunojnë dhe mund të publikojnë lëndë arkivore si dhe të mundësojnë, shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja të tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat-civil-juridik dhe qytetarë. Gjatë punës së këtij institucioni fillor të arsimit, u krijuar një fond i madh i dokumenteve arkivor në shkollën “Liria“ në Stroc.

Dokumentacioni arkivor i kësaj shkolle është i ndarë në disa lloje të fondeve:

1. **Aktetnormative** (*Statuti i shkollës, rregulloret e ndryshme etj.*)
2. **Lëndët që kanë të bëjnë me punët e organeve** (*Ftesat, Procesverbalet...*),
3. **Lëndët që kanë të bëjnë me krijimin e marrëdhënies së punës dhe ndërprerjen e punës** (*Librezat, dosjet, vendimet, konkurset...*),
4. **Lëndët lidhur me kohën e punës, pushimit, mungesa nga puna dhe pushimet mjekësore** (*ditët e punës, numri i orëve javore, planet e punës, vendimet e pushimeve*),
5. **Lëndët lidhur me ndarjen e të ardhurave personale** (*Vendimet për të ardhurat personale, për vlerat e poenëve, për shpenzimet e transportit etj.*),
6. **Statistika** (*Raportet për suksesin e nxënësve, për punëtorët e shkollës etj.*),
7. **Lëndë që kanë të bëjnë rreth themelimit të shkollës** (*Vendimi i themelimit të shkollës, i territorit, i emërimit, i regjistrimit etj.*),
8. **Punët juridike e të përgjithshme** (*Raportet e organeve kompetente mbi kuadrin udhëheqës të shkollës, kualifikimet e punëtorëve, aktvendimet për shpërblime, lëvdata etj.*),
9. **Punët byro teknike** (*Libri i protokollit, Libri arkivor, Procesverbalet mbi kontrollimin e lëndës arkivore, Vulat etj.*),
10. **Punët financiare** (*Llogaritë e ndryshme, Kartoteka financiare, Lista e rrogave, Libri i mjeteve themelore etj.*),
11. **Organet profesionale** (*Procesverbalet e Këshillit të Arsimitarëve, Këshillit të Paraleleve, Aktiveve profesionale etj.*),
12. **Lëndët tjera që kanë të bëjnë me arsimin** (*Libri amzë, Ditarët e klasave, Procesverbalet mbi provimet plotësuese të nxënësve etj.*),
13. **Grupet dhe aktivitetet kulturore e sportive** (*Grupi letrar, grupet sportive, Biblioteka, albumet fotografike, Mirënjohjet, Diplomat, Kabinetet etj.*)

Në përgjithësi, u krijuan dokumente me vlerë **të përhershme** dhe **të përkohshme**.

Gjatë ndërrimit të lokalit shkollor dokumentacioni arkivor pësoi dëme dhe shkatërrim. Po dëmin dhe shkatërrimin më të madh dokumentacioni arkivor i shkollës në Stroc e pësoi gjatë luftës 1998-1999, kur forcat serbe ushtarake dhe policore dogjën shkollat e fshatrave Stroc, Beçuk, Bivolak, Gllavotin dhe Zhilivodë, e bashkë me to edhe gjithë dokumentacionin arkivor.

Viti shkollor 1999/2000 filloi në objektet e rindërtuara shkollore. Kështu rifilloi edhe krijimi i dokumentacionit arkivor në shkollë. Me punën dhe angazhimin e palodhshëm të stafit administrativ dhe menaxherial të shkollës në Stroc, arkivi i shkollës u pasurua me dokumentacion arkivor. Disa dokumente u gjetën në arkivin historik të qytetit në Vushtrri, të cilat u fotokopjuan dhe u sollën në shkollë, një pjesë të dokumentacionit e sollën disa ish drejtorë nga arkivat e tyre private dhe një pjesë u krijuan gjatë punës së përditshme njëzetepesëvjeçare.

Sot shkolla e Strocit posedon një arkiv të pasur me dokumentacione të përhershme dhe të përkohshme. Dokumentacioni arkivor në shkollën e Strocit tani ruhet shumë mirë, ruhet edhe me ligj të posaçëm. Ai ruhet në letër, në mjete elektroteknike, në fotografi, në punime të nxënësve, certifikata, mirënjohje, dekorata etj.

Disa nga këto dokumente dhe fotografi, që sot i posedon shkolla në arkivin e vet, janë paraqitur në këtë punim të diplomës “**VEPRIMTARIA E SHKOLLËS SË MESME TË ULTË “LIRIA” NË STROC, SPAS DOKUMNTACIONIT TË SHKOLLËS DHE ARKIVIT KOMUNAL**”.

Përveç të dhënave të paraqitura në mënyrë të përgjithshme më sipër, e për qartësi më të madhe, sa i përket përmbajtjes së punimit, për nga struktura, ai ka abstraktin, parathënien, hyrjen, pesë kapituj, burimet dhe literaturën e shfrytëzuar.

///////

